

K O N K L U Z I O N
Nr.09-575/1 dt. 01.06.2016
PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR THEMELIMIN
E KËSHILLIT RINOR NË KOMUNËN E DIBRËS

552.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibrë (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibrë:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për themelimin e Këshillit rinor në Komunën e Dibrës, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 36^{të} dt. 30.05.2016.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

VENDIM
Nr.08-550/3 dt. 30.05.2016
PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT RINOR
NË KOMUNËN E DIBRËS

553.Në mbështetje të nenit 36, paragrafi (1), pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 5/02), Strategjisë Nacionale për Rininë e Republikës së Maqedonisë dhe Kërkesës për themelimin e Këshillave Lokale Rinore nga Agjencia për të rinj dhe sport (me nr. tonë: 03-1079/2, të dt. 30.10.2014),

Këshilli i Komunës së Dibrës, në seancën e 36^{të}, dt. 30.05.2016 vendosi:

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë Vendim rregullohet themelimi i Këshillit Rinor në Komunën e Dibrës (në tekstin e mëtutjeshëm Këshilli Rinor) fushëveprimi i punës, përbërja dhe numri i anëtarëve, koordinatori, mandati, mënyra e ndikimit të punës në Këshillin e Komunës, format e bashkëpunimit me organet tjera në Komunë, financimi dhe çështje tjera me rëndësi për punën e Këshillit Rinor, që në mënyrë aktive ata të përfshihen në jetën publike në Komunë.

Neni 2

Këshilli Rinor është trup këshilldhënës i Komunës së Dibrës dhe themelohet me qëllim të inkuorporimit të rinisë së Dibrës në proceset e vendimmarrjes së pushtetit lokal.

Neni 3

Të rinj, në kontekst të këtij vendimi janë shtetasit e Republikës së Maqedonisë me vendbanim në komunën e Dibrës, të moshës prej 15 deri më 29 vjeç. Të rinjtë nga paragrafi 1 i këtij vendimi mund të jenë të zgjedhur për kryetar dhe zëvendës kryetar të Këshillit Rinor të Dibrës, vetëm nëse janë me vendbanim në Komunën e Dibrës.

THEMELIMI I KËSHILLIT RINOR

Neni 4

Vendimin për themelimin e Këshillit Rinor e sjellë Këshilli i Komunës, në bazë të dispozitave pozitive ligjore.

FUSHËVEPRIMI I PUNËS

Neni 5

Në kuadër të fushëveprimit të vet të punës, Këshilli Rinor:

- debaton në seancë të Këshillit Rinor për çështje të rëndësishme për punën e tyre;
- debaton për çështje për të cilat debatohet në Këshillin e Komunës, e janë me interes për punën e të rinjve;
- i propozon Këshillit të Komunës programe, vendime, dhe akte të tjera me rëndësi për të rinjtë në komunë;
- i propozon Këshillit të Komunës që të debatojë për çështje të cilat janë me rëndësi për avancimin e pozitës së të rinjve dhe zgjidhjen e çështjeve të cekura;
- i jep mendim Këshillit të Komunës për vendime konkrete që duhet t'i miratojë;
- bashkëpunon në përpilimin dhe ndjek zbatimin e akteve lokale për rininë, të miratuara nga ana e Komunës;
- përpilon raporte deri te organet kompetente për problemet e të rinjve, kurse sipas nevojës propozon miratimin e programeve për mënjanimin e problemeve të shkaktuara dhe përmirësimin e pozitës së të rinjve në nivel lokal;
- kujdeset për informimin e të rinjve për të gjitha çështjet e rëndësishme për avancimin e pozitës së të rinjve;
- e nxit bashkëpunimin reciprok komunal dhe shkëmbimin e përvojave me të rinjtë e komunave tjera;
- i propozon Këshillit të Komunës plan financiar për realizimin e programeve të punës së Këshillit Rinor;
- sipas nevojës, fton përfaqësues të Këshillit të Komunës në seancat e veta;
- kryen edhe punë të tjera me interes për të rinjtë.

PËRBËRJA DHE PROCEDURA PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT RINOR

Neni 6

Këshilli Rinor përbëhet prej njëmbëdhjetë anëtarëve, përfshirë këtu kryetarin dhe zëvendësin e kryetarit.

Neni 7

Anëtarë të Këshillit Rinor janë automatikisht kryetarët e shkollave të mesme të zgjedhur sipas akteve të brendshme të shkollave të mesme komunale, të miratuar nga Këshillat e shkollave përkatëse.

Përveç anëtarëve si kryetarë të shkollave të mesme komunale, Anëtarët e mandatit të kaluar ngrenë procedurë për zgjedhjen e anëtarëve të rinjë me shpallje publike.

Kandidatët për anëtarë të Këshillit Rinor i propozojnë shoqatat rinore dhe shoqatat të cilat merren me të rinjtë, këshillat studentore, forma të tjera të regjistruara të organizimit të të rinjve dhe të rinj të cilët me vetë dëshirë aplikojnë në shpalljen publike.

Në bazë të propozimeve me shkrim nga propozuesit dhe propozuesit e autorizuar, Këshilli i Komunës e zgjedh dhe e shkarkon Këshillin Rinor, në propozim nga komisioni kompetent, në kuadër të Këshillit.

Kryetari dhe zëvendësi i tij, zgjidhen në përputhje me Rregulloren e punës së Këshillit Rinor.

Kryetari i Komunës nga ana e administratës të Komunës së Dibrës e emëron koordinatorin e Këshillit Rinor, pas zgjedhjes së anëtarëve të të njëjtit.

Detyrat punuese të Koordinatorit të Këshillit Rinor do të përcaktohen me aktet e brendshme të Këshillit Rinor.

MANDATI DHE ANËTARËT E KËSHILLIT RINOR

Neni 8

Anëtarët e Këshillit Rinor zgjidhen në 4 vjet.

Këshilli i Komunës mund të shkarkojë anëtar të Këshillit të rinisë edhe para skadimit të mandatit:

- me kërkesë personale,
- nëse ka mbushur moshën 29 vjeç,
- nëse mungon pa arsye në seancat e Këshillit të rinisë,
- nëse me aktgjykim të plotfuqishëm është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje më shume se gjashtë muaj.

MËNYRA E PUNËS

Neni 9

Këshilli Rinor mban seanca të rregullta sipas nevojës, por së paku një herë në muaj.

Seancat i thërret dhe me ato kryeson Kryetari i Këshillit Rinor ose Koordinatori.

Kryetari i këshillit është i obliguar të thërrasë seancë të jashtëzakonshme të këshillit të rinisë me propozim të së paku 1/3 e anëtarëve të Këshillit Rinor.

Neni 10

Këshilli Rinor i sjell vendimet me shumicë votash nëse në seancë marrin pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur të Këshillit Rinor.

Anëtari i Këshillit Rinor i cili personalisht është i interesuar për sjelljen e vendimit për ndonjë çështje, mund të merr pjesë në debatin mbi atë çështje, por është i përjashtuar nga vendimmarrja.

Përjashtimi nga vendimmarrja mbi ndonjë çështje bëhet për shkak nëse ka të bëjë me marrjen e vendimit për ndonjë projekt në të cilin ai personalisht merr pjesë ose merr pjesë si person juridik në të cilin ai ka aksione ose pronësi.

Neni 11

Këshillin Rinor e prezanton dhe përfaqëson Kryetari i Këshillit Rinor dhe koordinatori i Këshillit Rinor.

Neni 12

Këshilli Rinor mund të formojë trupa punuese më të ngushta të përhershme dhe të përkohshme të veprimit, për organizim të forumeve, tribunave dhe punëtorive për grup moshë të caktuara të rinjve ose për lloje të ngjashme të problemeve të cilat brengosin të rinjtë.

Këshilli Rinor merr pjesë në punën e Këshillit të Komunës së Dibrës, në debat për çështje të caktuara, por pa të drejtë vote.

Neni 13

Këshilli Rinor sjellë Rregullore për punën e vet.

Rregulloren për punën e Këshillit Rinor e sjellë me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit Rinor.

Me Rregulloren e punës më për së afërmi rregullohet mënyra e punës, zgjedhja e kryetarit dhe zëvendësit të tij në përputhje me këtë Vendim.

FORMAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 14

Këshilli Rinor sjellë Program për punën e Këshillit Rinor dhe e dorëzon deri te Këshilli i Komunës për çdo vit kalendarik.

Programi i përmban aktivitetet vijuese:

-pjesëmarrje në përpilimin dhe ndjekjen e Programit për punë të rinjve në pushtetin lokal;

-bashkëpunim me trupat tjerë këshilldhënës në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë ;

-konsultim me organizata rinore për tema me rëndësi për rininë;

-bashkëpunon me organet në komunë për politikën ndaj të rinjve;

Programi përmban edhe aktivitete tjera, të rëndësishme për punën e Këshillit Rinor dhe përmirësimin e pozitës së të rinjve;

Programin për punë, Këshilli Rinor e sjellë me shumicë votash nga të gjithë anëtarët e Këshillit Rinor.

Programi sillet dhe dorëzohet te komisioni kompetent në kuadër të këshillit, më së voni deri më 30 nëntor në vitin vijues, për vitin e ardhshëm.

Neni 15

Në rast se, me Programin për punë të Këshillit Rinor për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara parashihet nevoja për sigurim të mjeteve financiare në buxhetin e komunës, propozohet edhe plan financiar.

Programin nga paragrafi 1 i këtij neni, e miraton Këshilli i Komunës së Dibrës.

Neni 16

Këshilli Rinor dorëzon rregullisht raporte semestrale për punën e vet deri te këshilli i Komunës së Dibrës.

MJETET PËR PUNË TË KËSHILLIT RINOR

Neni 17

Komuna e Dibrës siguron mjete financiare për punën e Këshillit Rinor dhe hapësirë për mbajtjen e seancave të Këshillit Rinor në Komunën e Dibrës.

Anëtarët e Këshillit Rinor nuk pranojnë kompensim për punën e vet.

Anëtarët e Këshillit Rinor kanë të drejtë kompensimi për shpenzimet për punën e vet vetëm nëse ato janë përcaktuar me programin vjetor të planit financiar.

Neni 18

Punët profesionale dhe administrative për nevojat e Këshillit Rinor, i kryen administrata e Komunës së Dibrës.

Neni 19

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Kumtesën zyrtare të Komunës së Dibrës”.

KËSHILLI I KOMUNËS

Kryetari,

Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N

Nr.09-575/2 dt. 01.06.2016

**PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR LIRIM TË PAGESËS TË
KOMPENSIMIT PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE PËR
NDËRTIMIN E TERENIT SPORTIV PËR SHUMË QËLLIME NË
FSHATIN KOSOVRAS T I EPËRM, KOMUNA DIBËR**

554.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për lirim të pagesës të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtimin e terrenit sportiv për shumë qëllime në fshatin Kosovrast i Epërm, Komuna Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 36^{të} dt. 30.05.2016.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr.08-550/4 dt.30.05.2016

**PËR LIRIM TË PAGESËS TË KOMPENSIMIT PËR RREGULLIMIN E
TOKËS NDËRTIMORE PËR NDËRTIMIN E
TERENIT SPORTIV PËR SHUM QËLLIME NË FSHATIN
KOSOVRAST I EPËRM, KOMUNA DIBËR**

555.Në mbështetje të nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, (“Gazeta zyrtare e RM-së nr. 5/02) dhe nenit 27 të Statutit të komunës Dibër, (“Kumtesa zyrtare e komunës Dibër” nr. 14/03) në lidhje me nenin 59 paragrafi 12 i Ligjit për ndërtim (“Gazeta zyrtare RM-së” nr. 130/09,124/10,18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14, 44/15, 129/15, 217/15, 226/15, 30/16, 31/16, 39/16 dhe 71/16),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 36^{të} datë 30.05.2016 vendosi:

Neni 1

Agjencioni për të Rinj dhe Sport i Republikës së Maqedonisë lirohet nga pagesa e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtimin e terenit sportiv për shumë qëllime në PK. 1215 KK Kosovrast i Epërm, Komuna Dibër.

Neni 2

Tereni sportiv për shumë qëllime financohet me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë ndësa realizohet përmes Agjencionit për të Rinj dhe Sport i RM dhe do të ndërtohet në përputhje me dokumentacionin teknik me nr. tek. OP-15/16, i punuar nga "Hidro gradezhen inzhenering" -Shkup.

Neni 3

Njësija e Vetëqeverisjes Lokale Komuna Dibër në rast nevojë merr përsipër rregullimin e tokës ndërtimorre lidhur me ndërtimit e objektit nga neni 1 i vendimit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën zyrtare e komunës Dibër”.

KËSHILLI I KOMUNËS

Kryetari,

Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N

Nr.09-575/3 dt. 01.06.2016

**PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E NEVOJËS PËR
SJELLJEN E DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR PËR
HARMONIZIM TË DESTINIMIT TË PJESE TË TOKËS NDËRTIMORE
PËR PK NR. 7049 KK DIBËR-2**

556.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit urbanistik planor për harmonizim të destinimit të pjese të tokës ndërtimore për PK nr. 7049 KK Dibër-2, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 36^{të} dt. 30.05.2016.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr.08-550/5 dt. 30.05.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E NEVOJËS PËR SJELLJEN E
DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR PËR HARMONIZIM
TË DESTINIMIT TË PJESE TË TOKËS NDËRTIMORE PËR
PK NR. 7049 KK DIBËR-2**

557.Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit për veprim me objekte të ndërtuara pa leje ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/11, 54/11, 155/12, 72/13, 44/14, 115/14, 199/14, 124/15, 129/15, 217/15 dhe 31/16), nenit 2 paragrafi 2 të Rregullores për standarde për përshtatjen e objekteve të ndërtuara pa leje në dokumentacionin urbanistik planor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 56/11, 162/12, 95/13, 109/14 64/15, 217/15 dhe 52/16), dhe nenit 27 të Statutit të Komunës Dibër ("Kumtesa zyrtare e komunës Dibër nr. 14/03),

Këshilli i komunës Dibër në seancën e 36^{të} dt. 30.05.2016, vendosi:

Neni 1

Përcaktohet nevoja për sjelljen e dokumentacionit urbanistik planor për harmonizim të destinimit të tokës ndërtimore, për përcaktimin e statusit juridik të objektit pa leje, Objekti nr.3, shtëpi banimi me destinim A1 tip (Pr+K1+Ma) e cila është ndërtuar në PK nr. 7049 KK DIBËR-2, objekti është pronë e Burim Çikrit nga Dibra.

Sipas Planit detal urbanistik për qytetin Dibër lista detale nr.4, toka ku është ndërtuar objekti është parapa me destinim gjelbërim D1.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë, nga dita e shpalljes në „Kumtesën zyrtare,, të Komunës Dibër.

KËSHILLI I KOMUNËS

Kryetar,

Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.09-575/4 dt. 01.06.2016
PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR DHËNIE PËLQIM

558.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për dhënie pëlqim, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 36^{të} dt. 30.05.2016.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M
Nr. 08-550/6 dt. 30.05.2016
PËR DHËNIE PËLQIM

559.Në mbështetje të nenit 36 të Ligjit për vetadministrim lokal (“Gazeta zyrtare e R.M. nr. 5/2002) nenit 27 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës Dibër nr.14/03), në lidhje me nenin 11 të Ligjit për ndërmarrjet publike (“ Gazeta zyrtare e R.M. nr. 38/96, 6/02, 40/06, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14 dhe 25/15, 61/15 dhe 39/16),
Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 36^{të} dt. 30.05.2016 vendosi:

1.Këshilli i komunës jep pëlqim në vendimin për miratimin e llogarisë përfundimare të Ndërmarrjes Komunale Publike ”Standard” Dibër për vitin 2015, Nr.02-45 miratuar nga Këshilli drejtues i Ndërmarrjes në mbledhjen e mbajtur më dt. 20.02.2016.

2.Ky vendim hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në “Kumtesën zyrtare të Komunës Dibër”

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.09-575/5 dt. 01.06.2016
PËR SHPALLJEN E PËRFUNDIMIT PËR MOS MIRATIMIN E
RAPORTIT PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR MIRËMBAJTJEN
E PASTËRTISË PUBLIKE NË TERRITORIN E
KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2015

560.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet përfundimi për mos miratimin e Raportit për realizimin e Programit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2015, që solli Këshilli i Komunës në seancën e 36^{të} dt. 30.05.2016.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

P Ë R F U N D I M
Nr. 08-550/7 dt. 30.05.2016
PËR MOS MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E
PROGRAMIT PËR MIRËMBAJTJEN E PASTËRTISË PUBLIKE NË
TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2015

561.Në mbështetje të nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale („Gazeta Zyrtare e RM,, nr.5/02) si dhe nenit 59 të Statutit të komunës („Kumtesa Zyrtare e Komunës,, nr 14/03) në lidhje me raportin për realizimin e Programit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2015, Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 36^{të} datë 30.05.2016 përfundoi:

1.Këshilli i Komunës Dibër nuk e miratoi Raportin për realizimin e Programit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2015 paraqitur nga realizuesi i Programit, NKP”Standard”-Dibër.

2.Ky përfundim hyn në fuqi një ditë pas shpalljen në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N

Nr.09-575/6 dt. 01.06.2016

**PËR SHPALLJEN E PËRFUNDIMIT PËR MOS MIRATIMIN E
PROPOZIM PROGRAMIT PËR MIRËMBAJTJEN E HIGJIENËS
KOMUNALE NË TËRRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2016**

562.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet përfundimi për mos miratimin e propozim Programit për mirëmbajtjen e higjienës komunale në territorin e Komunës Dibër për vitin 2016, që Këshilli i Komunës solli në seancën e 36^{të} dt. 30.05.2016.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

P Ë R F U N D I M

Nr. 08-550/8 dt. 30.05.2016

**PËR MOS MIRATIMIN E PROPOZIM PROGRAMIT PËR
MIRËMBAJTJEN E HIGJIENËS KOMUNALE NË TERRITORIN E
KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2016**

563.Në mbështetje të nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale („Gazeta Zyrtare e RM,, nr.5/02) si dhe nenit 59 të Statutit të komunës („Kumtesa Zyrtare e Komunës,, nr 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 36^{të} datë 30.05.2016 përfundoi:

1.Këshilli i Komunës Dibër nuk e miratoi propozim Programin për mirëmbajtjen e higjienës komunale në territorin e Komunës Dibër për vitin 2016, nga NKP”Standard”-Dibër. E njejta të korigjohet dhe plotësohet duke dorëzuar në seancën e ardhëshme para Këshillit të Komunës.

2.Ky përfundim hyn në fuqi një ditë pas shpalljen në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.09-575/7 dt. 01.06.2016
PËR SHPALLJEN E PËRFUNDIMIT PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT
VJETOR PËR PUNËN E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT TË
NKP'STANDARD'-DIBËR PËR VITIN 2016

564.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet përfundimi për miratimin e Programit vjetor për punën e Ujësjiellësit dhe Kalalizimit në NKP”Standard”-Dibër për vitin 2016 , që Këshilli i Komunës solli në seancën e 36^{të} dt. 30.05.2016.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

P Ë R F U N D I M
Nr. 08-550/9 dt. 30.05.2016
PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT VJETOR PËR PUNËN E
UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT TË
NKP'STANDARD'-DIBËR PËR VITIN 2016

565.Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale („Gazeta Zyrtare e RM,, nr.5/02) si dhe nenit 59 të Statutit të komunës („Kumtesa Zyrtare e Komunës,, nr 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 36^{të} datë 30.05.2016 përfundoi:

1.Këshilli i Komunës Dibër miratoi Programit vjetor për punën e Ujësjiellësit dhe Kanalizimit në NKP”Standard”-Dibër për vitin 2016

2.Pjesë përbërëse e përfundimit është Programi nga pika 1.

3.Ky përfundim hyn në fuqi një ditë pas shpalljen në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.09-575/8 dt. 01.06.2016
PËR SHPALLJEN E PËRFUNDIMEVE TË
KËSHILLIT TË KOMUNËS DIBËR

566.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet përfundimet e Këshillit të Komunës Dibër për SHA EVN Maqedonija, miratuar në seancën e 36^{të} dt. 30.05.2016.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

567.Në mbështetje të 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03), në lidhje me kërkesën e Shoqatave joqeveritare në Komunën e Dibrës ,

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 36^{të} dt. 30.05.2016 miratoi këto:

P Ë R F U N D I M E

1.SHA EVN Maqedonia të kthejë të gjitha shërbimet e mëparshme në qytetin e Dibrës, që ka kryer Ndërmarrja “Elektrodistribucioni”-Dibër ndaj konsumatorëve dhe qytetarëve, gjegjësisht EVN Maqedonia të kthejë funksionimin e plotë të QEK-ut në qytetin e Dibrës.

2.Faturat e rrymës elektrike të jenë në dy gjuhë, që konsumatori shqiptar të ketë më të lehtë të kuptojë se çka është rregjistruar dhe për çka paguan.

3.Kërkojmë përgjigje në kërkesat e mësipërme në afat prej 30 ditëve.

4.Përfundimet të dërgohen SHA EVN Maqedonia-Shkup dhe QEK-Strugë.

5.Këto përfundime hyjnë në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallen në Kumtesën zyrtare të Komunës.

Nr.08-550/10
30.05.2016
D i b ë r

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

P Ë R M B A J T J A

552	Konkluzion për shpallje të vendimit për themelimin e Këshillit rinor në Komunën e Dibrës	_____	1065
553	Vendim për themelimin e Këshillit rinor në Komunën e Dibrës për themelimin e Këshillit rinor në Komunën e Dibrës	_____	1066
554	Konkluzion për shpallje të vendimit për lirim të pagesës të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtimin e terenit sportiv për shumë qëllime në fshatin Kosovrast i Epërm, Komuna Dibër	_____	1071
555	Vendim për lirim të pagesës të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtimin e terenit sportiv për shumë qëllime në fshatin Kosovrast i Epërm, Komuna Dibër	_____	1072
556	Konkluzion për shpallje të vendimit për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit urbanistik planor për harmonizim të destinimit të pjese të tokës ndërtimore për PK nr. 7049 KK Dibër-2	_____	1073
557	Vendim për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit urbanistik planor për harmonizim të destinimit të pjese të tokës ndërtimore për PK nr. 7049 KK Dibër-2	_____	1074
558	Konkluzion për shpallje të vendimit për dhënie pëlqim	_____	1075
559	Vendim për dhënie pëlqim	_____	1076
560	Konkluzion për shpallje të përfundimit për mos miratimin e Raportit për realizimin e Programit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2015	_____	1077
561	Përfundim për mos miratimin e Raportit për realizimin e Programit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2015	_____	1078
562	Konkluzion për shpallje të përfundimit për mos miratimin e propozim Programit për mirëmbajtjen e higjienës komunale në territorin e Komunës Dibër për vitin 2016	_____	1079
563	Përfundim për mos miratimin e propozim Programit për mirëmbajtjen e higjienës komunale në territorin e Komunës Dibër për vitin 2016	_____	1080
564	Konkluzion për shpallje të përfundimit për miratimin e Programit vjetor për punën e Ujësjellësit dhe Kalalizimit në NKP"Standard"-Dibër për vitin 2016	_____	1081
565	Përfundim për miratimin e Programit vjetor për punën e Ujësjellësit dhe Kalalizimit në NKP"Standard"-Dibër për vitin 2016	_____	1082
566	Konkluzion për shpallje të përfundimeve e Këshillit të Komunës Dibër për SHA EVN Maqedonija	_____	1083
567	Përfundime të Këshillit të Komunës Dibër për SHA EVN Maqedonija Shkup		1084

PËRGATITI : SHËRBIMI PRANË KËSHILLIT